Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 94/17
Datë/Datum. 26.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 94/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 paragrafi 2, pika 2.16, nenit 106, nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 26 të Rregullores së Punës, në përbërje prej **Ekrem Salihu -Kryetar, Tefik Sylejmani-Referues, Goran Milenkovič-Anëtar, Nuhi Paçarizi -Anëtar** dhe **Blerim Dina - Anëtarë**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 94/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"EL-BAU& VEMOR" sh.p.k.** me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike"**, me nr. të prokurimit: 651/16/052/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Gjilanit, në seancën e dt. 23 maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** , ankesa e operatorit ekonomik **"EL-BAU & VEMOR" sh.p.k** me seli në Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i rrugëve, trotuarve, mirëmajtja e parqeve dhe hapësirave publike"**, me nr. të prokurimit: 651/16/052/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Gjilanit, si e bazuar.

II. **ANULOHET,** vendimi i autoritetit kontraktues-Komunës së Gjilanit, njoftim për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i rrugëve, trotuarve, mirëmajtja e parqeve dhe hapësirave publike"**, me nr. të prokurimit:651/16/052/211, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim, sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues .

III. Konforom nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së, OSHP-ja do ti drejtohet KRPP-së, për marrjen e licencës z. Salih Kçiku-Zyrtar i Prokurimit, për mos zbatim të Urdhëresës PSH. Nr. 66/17, të dt. 20 prill 2017, si dhe për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të këtij zyrtari të prokurimit që i ka bërë në aktivitetet e ndryshme të prokurimit.

IV. Komform nenit 131 të LPP-së, autoritetit kontraktues Komunës së Gjilanit i shqiptohet gjoba në shumë prej 10,000.00 (dhjetë mijë euro), për mos zbatimin të urdhëresës së PSH-së me nr. 66/17, të dt. 20 prill 2017.

V. **OBLIGOHET**, autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit, që gjobën e lartë cekuar ta paguaj ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, në xhirollogarinë e OSHP-së: Nr. 1000 4300 7000 5756 / Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

VI. Operatorit ekonomik ankues **"EL-BAU & VEMOR" sh.p.k** me seli në Gjilan, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VII. Urdhërohet, OE. ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues–Komuna e Gjilanit, më dt. 03 gusht 2016, ka publikuar *Njoftim për kontratë,* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike",** me nr. të prokurimit:651/16/052/211.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 2 (nëntë) operator ekonomik, ku sipas komisioni të vlerësimit të ofertave 1 (një) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit, ndërsa 1 (një) operator ekonomik është i pa përgjegjshëm pasi që nuk i plotëson kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues, më dt. 17 mars 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim, të dt. 22 mars 2017, operatori ekonomik **"EL-BAU & VEMOR" sh.p.k.** me seli në Gjilan, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 52, nenit 56, nenit 59, nenit 60 dhe nenit 72 të LPP-së, si dhe nenit 18.5, nenit 26.1, 26.2 dhe nenit 26.6 pika 1.3, 1.4, I Rregullave për Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e **bazuar**.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 19 prill 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me datën 26 prill 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues vlerëson se qëndron, sepse autoriteti kontraktues nuk ka vepruar konform LPP-së, parimeve kryesore te prokurimit, konkurrencës, efikasitetit, efektivitetit, drejtësisë/mos diskriminimit, kushteve të barabarta në mënyrë të drejtë dhe me qëllim të zgjidhjes ligjshëm, rregullave te prokurimit publik, andaj edhe mënyrën efikase, transparente dhe ekonomike te shfrytëzimit te drejtë të fondeve.

Eksperti shqyrtues/teknik, sqaron se autoriteti kontraktues- Komuna- Gjilan ka bërë shkelje të LPP-së, nenit 26.8 të Rregullave për Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, nenit 69.4, neni 104, neni 56, neni 59 paragrafi 2 dhe 4, neni 60 paragrafi 1.1, neni 72 lidhur me nenin 1, nenin 6, nenin 7, andaj ky proces i prokurimit duhet të vlerësohet si çështje e shqyrtuar dhe e gjykuar në bazë të vendimit të PSh. Nr. 446/16, i dt. 25 janar 2017, sepse nga autoriteti kontraktues janë përsëritur arsyet e njëjta për lenden e njëjtë të cilat janë gjykuar me anë të këtij vendimi.

Bazuar në atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues, të dt. 17 mars 2017, dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit, përmes parashtresës me shkrim të dt. 03 maj 2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me konstatimet e ekspertit shqyrtues/teknik të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 26 prill 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të dt. 28 prill 2017, njofton panelin shqyrtues se pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues/teknik të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 26 prill 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të rivlerësimit të ofertave, raporti i rivlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik i dt. 26 prill 2017, si dhe parashtresa e autoriteti kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Eksperti shqyrtues gjatë seancës dëgjimore deklaroj: ashtu siç ka konstatuar eksperti shqyrtues/teknik në raportin e dt. 26 prill 2017, i propozoj panelit shqyrtues që të aprovoj ankesën e operatorit ekonomik ankues si të bazuar dhe lënda për këtë aktivitet të prokurimit të kthehet ne rivlerësim.

Eksperti shqyrtues gjatë prezantimit në seancë sqaroj se te gjitha pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga eksperti teknik të cilat i gjeni ne raporti e ekspertizës së dt. 26 prill 2017.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues **"EL-BAU&VEMOR" sh.p.k.** me seli në Gjilan me nr. të protokollit 94/17, të dt. 03 prill 2017, raportin e ekspertit shqyrtues/teknik, të dt. 26 prill 2017, konstaton se paneli shqyrtues i OSHP-së, lidhur me arsyet e eliminimit të operatorit ekonomik ankues ka vendosur ne mënyrë meritore: me vendimin PSH. Nr. 446/16, i dt. 25 janar 2017, ku përmes të njëjtit vendim ka shqyrtuar-arsyetuar dhe vendosur lidhur me pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues, dhe ka konstatuar se nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik ankues lidhur me kërkesën e specifikuar ne pikën 9.2 pika 2 të FTD-së, ka ofruar dëshmi ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Prandaj, paneli shqyrtues në mbështetje të nenit 105 paragrafi 2.16, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe Rregullores së punës së OSHP-së, nr. 01/2017, neni 16 paragrafi 3, sqaron si të gjykuar pretendimet ankimore.

Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e gjobës pati parasysh faktin se autoriteti kontraktues në vazhdimësi nuk ka respektuar vendimet e panelit shqyrtues të OSHP-së, të cilat janë nxjerr si rezultat i ankesave të operatorëve ekonomik ankues siç janë: Vendimi i PSh. Nr. 25/16, dt. 11 maj 2016, Vendimi i PSh. Nr. 217/16, të dt. 10 gusht 2016, Urdhëresën e PSh. Nr. 370/16, të dt. 17 nëntor 2016, Vendimi e PSh. Nr. 446/16, të dt. 24 janar 2017, Vendimi e PSh. Nr. 47/17, të dt. 05 prill 2017, si dhe Urdhëresën e PSh. Nr. 66/17, të dt. 20 prill 2017.

Paneli shqyrtues konstaton se mos respektimi i urdhëresës me nr. të protokollit 66/17, dt. 20 prill 2017, si dhe vendimeve të lartë përmendura , e detyron panelin shqyrtues konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së, që të veproj ndaj autoritetit kontraktues, si dhe konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit, të kërkon nga KRPP-ja që të bëjë anulimin e certifikatës profesionale të prokurimit të menaxherit të prokurimit z. Salih Kçiku për shkak se i njëjti ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së, ku i njëjti nuk ka bërë zbatimin e Urdhëresave (Vendimeve) PSH. nr. 66/17, të dt. 20 prill 2017 . Paneli shqyrtues gjithashtu konstaton se z. Kçiku, nga provat e prezentuara më lart, vlerësohet si recidivist për shkelje të dispozitave të LPP-së.

Prandaj, konform nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të vendimit.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komunës së Gjilanit
1x1 OE - "EL-BAU&VEMOR" sh.p.k. me seli në Gjilan
1x1 Arhivës së OSHP-së
1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.